



FEDERATA E TENISIT TË KOSOVËS
TENISKA FEDERACIJA KOSOVA
TENNIS FEDERATION OF KOSOVA

www.tenniskosova.com; federation@tenniskosova.com; 044/14 22 90

Në bazë të nenit 2.1 të Statutit të Federatës së Tenisit të Kosovës, Kuvendi i FTK-së në takim të mbajtur më **14.01.2012** sjell këtë

RREGULLORE

E KAMPIONATIT EKIPOR NË TENIS

PËRMBAJTJA:

1.	SISTEMI I KAMPIONATIT EKIPOR TË KOSOVËS.....	1
2.	TERMINET	2
3.	SHORTI.....	2
4.	TITULLI	3
5.	REGJISTRIMI PËR PJESËMARRJE I EKIPEVE	3
6.	PARAQITJA E EKIPIT ME EMRA TË TENISTËVE.....	3
7.	PJESËMARRJA E JUNIORËVE NË KAMPIONAT	4
8.	DORËZIMI I TAKIMIT	4
9.	NDËRPRERJA E TAKIMIT	4
10.	KUSHTET PËR MBAJTJEN E KAMPIONATIT EKIPOR	4
11.	TOPAT.....	5
12.	PARAQITJA E EKIPIT PARA TAKIMIT.....	5
13.	ORARI I TAKIMEVE.....	5
14.	REFERËT KRYESOR.....	6
15.	KAPITENI I EKIPIT	6
16.	KËSHILLI MBIKQYRËS I KAMPIONATIT.....	6
17.	ANKESAT.....	7
18.	SHPENZIMET E KAMPIONATIT	7
19.	AKTET TJERA	7

1 SISTEMI I KAMPIONATIT EKIPOR TË KOSOVËS

1.1 Kampionati Ekupor i Kosovës për seniorë zhvillohet në sistem të kupës së



FEDERATA E TENISIT TË KOSOVËS
TENISKA FEDERACIJA KOSOVA
TENNIS FEDERATION OF KOSOVA

www.tenniskosova.com; federation@tenniskosova.com; 044/14 22 90

Dejvisit (Davis Cup) dhe organizohet në vitin kalendarik nga ana e Federatës së Tenisit të Kosovës.

- 1.2 Takimet zhvillohen me sistem të Davis Cup. Vlen sistemi i një takimi në mes të dy klubeve ku humbësi eliminohet ndërsa fituesi kalon në gjiron e ardhshme.
- 1.3 Takimet luhen me katër takime individuale (single) dhe 1 takim në dyshe (double).
- 1.4 Fitues është ekipi që ka më së shumti fitore nga 5 ndeshje.
- 1.5 Nëse ekipi fitues ka arritur numrin e fitoreve ku ekipi tjetër nuk mund të e rikthej rezultatit në favor të tij, takimet e mbetura mund të mos zhvillohen.
- 1.6 Takimet individuale zhvillohen me dy seta të fituara.
- 1.7 Në takimin në dyshe (double) seti i tretë luhet në tie-break deri në 10 poenë.

2. *TERMINET*

- 2.1 Terminet e takimeve të kampionatit ekipor caktohen nga FTK dhe janë të publikuara në Kalendarin vjetor të garave të FTK.
- 2.2 Termini i takimeve mund të ndryshoj vetëm për shkak të motit të ligë dhe mund të shtyhet më së largu për dy javë.
- 2.3 Takimet do të zhvillohen gjatë ditëve të vikendit.
- 2.4 Ekipi vendës cakton orën e fillimit të takimit.

3. *SHORTI*

Në fillim të sezonit hidhet shorti për Kampionatin ekipor të Kosovës
Ekipet vendëse caktohen ato të cilat kanë qenë mysafire në vitin paraprak
Nëse ka dy ekipe që kanë qenë mysafire atëherë me short caktohet ekipi vendës
Në kampionatin ekipor mund të luaj vetëm një ekip i të njëjtit klub.



**FEDERATA E TENISIT TË KOSOVËS
TENISKA FEDERACIJA KOSOVA
TENNIS FEDERATION OF KOSOVA**

www.tenniskosova.com; federation@tenniskosova.com; 044/14 22 90

4. *TITULLI*

Fituesi merr titullin KAMPION EKIPOR I KOSOVËS NË TENIS PËR SENIORE

5. *REGJISTRIMI PËR PJESËMARRJE I EKIPEVE*

Klubet regjistrohen (konfirmojnë) pjesëmarrjen në kampionatin ekipor më së largu deri më 1 dhjetor për pjesëmarrjen e ekipit në kampionatin ekipor të vitit që vjen.

6. *PARAQITJA E EKIPIT ME EMRA TË TENISTËVE*

- 6.1 Lista me emra të tenistëve që do të luajnë në takimet e kampionatit ekipor i dërgohet FTK-së më së largu 7 ditë pra fillimit të takimit.
- 6.2 Në kohën e dërgimit të listës të gjithë tenistët e paraqitur në listë duhet të jenë të regjistruar në FTK.
- 6.3 Gjatë paraqitjes së tenistit të huazuar klubi është i detyruar të e paraqes në FTK lejen e klubit amë me shkrim. Paraqitja e tenistit pa lejen e klubit amë nuk do të lejohet.
- 6.4 Një tenist nuk ka të drejtë të luaj për dy klube të ndryshme të seniorëve gjatë një viti kalendarik por ka të drejtë të luaj për ekipin e juniorëve të ekipit amë në kampionatin ekipor të juniorëve.
- 6.5 Shtetasit e huaj me qëndrim të përhershëm në Kosovë e kanë statusin e lojtarit vendor.
- 6.6 Renditja e tenistëve në takimet e kampionatit duhet të bëhet sipas këtyre Krihereve

- Sipas rang-listës së ATP
- Sipas rang-listës së FTK për senior
- Seniorët e joranguar
- Sipas rang-listës së FTK për junior deri në 18 vjeç
- Juniorët e joranguar deri në 18 vjeç
- Sipas ranglistës së FTK për junior deri në 16 vjeç



FEDERATA E TENISIT TË KOSOVËS
TENISKA FEDERACIJA KOSOVA
TENNIS FEDERATION OF KOSOVA

www.tenniskosova.com; federation@tenniskosova.com; 044/14 22 90

- Juniorët e joranguar deri në 16 vjeç
- Sipas ranglistës së FTK për djelmosha deri në 14 vjeç
- Djelmoshat e joranguar deri në 14 vjeç

- 6.7 Në rast se dy apo më shumë tenistë kanë pikë të njëjta në rang-listë klubi vendos për renditjen e tyre. Renditja e lajmëruar në FTK nuk mund të ndryshohet.
- 6.8 Renditja vlen për ranglistat në kohën e paraqitjes së renditjes së tenistëve 7 ditë para takimit të kampionatit.

7. Pjesëmarrja e Juniorëve në Kampionat

Për kategorinë e seniorëve mund të paraqitet edhe tenistë që në vitin kalendarik i mbushin 14 vjeç.

8. Dorëzimi i Takimit

Mosardhja e ekipit në takim do të thotë dorëzim i takimit, regjistrimin e takimit me rezultat 0 : 5.

9. Ndërprerja e Takimit

- 9.1 Takimi mund të ndërprehet për shkak të shiut apo për shkak të fuqisë mbinatyrore. Vendimin për ndërprerje të takimit e merr referi kryesor i takimit. Vazhdimi i takimit të ndërprerë duhet të bëhet menjëherë pasi të krijohen kushtet, nëse është e mundur edhe nën dritat e reflektorëve.
- 9.2 Takimi vazhdon me përbërje të pandryshuara të ekipeve dhe tenistëve si dhe tek rezultati që është ndërprerë.
- 9.3 Nëse takimi nuk mund të vazhdoj në ditën kur ka filluar, referi kryesor cakton terminin e ri të takimit në marrëveshje me klubet.

10. Kushtet për Mbajtjen e Kampionatit Ekipor



FEDERATA E TENISIT TË KOSOVËS
TENISKA FEDERACIJA KOSOVA
TENNIS FEDERATION OF KOSOVA

www.tenniskosova.com; federation@tenniskosova.com; 044/14 22 90

- 10.1 Klubi vendës duhet të siguroj terrene kualitative, mirëmbajtje të terreneve dhe pajisje për pastrimin e ujit pas shiut në afat sa më të shkurtër.
- 10.2 Klubi vendas duhet të i siguroj ekipit mysafir terminet për ushtrime në terenet ku do të luhet takimi në kohëzgjatje prej 120 min në javën para zhvillimit të takimit nëse klubi mysafir bënë kërkesë për këtë.

11 TOPAT

- 11.1 Topat për të gjitha takimet e Kampionatit Ekipor të Kosovës i cakton dhe i siguron FTK.
- 11.2 Për takimet individuale dorëzohen nga 3 topa dhe 3 topa të rinj për setin e tretë eventual.

12. PARAQITJA E EKIPIT PARA TAKIMIT

- 12.1 Gjatë paraqitjes së ekipit secili klub e paraqet kapitenin e ekipit me numër të telefonit kontaktues.
- 12.2 Kapiteni i ekipit ia paraqet referit kryesor katër tenistët për takimet individuale më së paku 15 min para fillimit të takimit. Referi kryesor kontrollon fletëregjistrimet e tenistëve. Të gjithë tenistët duhet të jenë prezent në momentin e paraqitjes së ekipit.
- 12.3 Ekipi që nuk i ka katër tenistë me fletëregjistrime të rregullta në momentin e paraqitjes për takime individuale 15 min para fillimit të dy takimeve individuale i humb ato takime pa luftë.
- 12.4 Kapitenët e ekipeve i paraqesin tenistët për takimin e dysheve (double) 15 min para fillimit të takimit pas përfundimit të dy takimeve individuale (single). Takimi në dyshe (double) zhvillohet si takim i tretë.
- 12.5 Në rast se klubet ia dorëzojnë referit kryesor listën me renditjen e tenistëve për takime individuale që dallon nga lista e paraqitur në federatë referi kryesor e përmirëson renditjen e tenistëve sipas rregullave.

13. ORARI I TAKIMEVE



FEDERATA E TENISIT TË KOSOVËS
TENISKA FEDERACIJA KOSOVA
TENNIS FEDERATION OF KOSOVA

www.tenniskosova.com; federation@tenniskosova.com; 044/14 22 90

- 13.1 Takimet fillojnë në dy terene në të njejtën kohë jo më vonë se në ora 11. Ekipi vendës cakton cili takim në cilin teren do të luhet dhe e informon referin kryesor dhe kapitenin e ekipit mysafir para fillimit të takimit.
- 13.2 Takimi më double zhvillohet pas përfundimit të dy takimeve të para individuale më së voni gjysëm ore pas përfundimit të dy takimeve individuale.

14. REFERËT KRYESOR

- 14.1 Për çdo takim të Kampionatit të Kosovës përfaqësuesi i Unionit të referëve i delegon 3 referë.
- 14.2 Nëse për ndonjë arsye referët nuk janë prezent takimet i referojnë tenistët që në ato momente nuk i zhvillojnë takimet. Tre takime i referojnë tenistët vendës dhe dy takime tenistët mysafir. Tenistët mysafir mund të zgjedhin që të mos referojnë dhe atëherë takimet i referojnë vetëm tenistët vendës.

15 KAPITENI I EKIPIT

- 15.1 Kapiteni i ekipit e paraqet ekipin e tij dhe e nënshkruan procesverbalin e takimit pas përfundimit të tij. Kapiteni i ekipit duhet të jetë trajner i licensuar
- 15.2 Kapiteni i ekipit ka të drejtë të jep vërejtje në procesverbal ose të paraqes ankesë në federatë.
- 15.3 Kapiteni i ekipit dhe zëvendësit e tyre kanë të drejtë të qëndrojnë brenda rrethojës së terenit dhe të i këshillojnë tenistët gjatë kohës së ndërrimit të anëve. Gjatë gjithë kohës së takimit në teren mund të jenë vetëm kapiteni dhe zëvendësi i tij. Kapiteni i ekipit e paraqet zëvendësin e tij te referi kryesor. Zëvendës mund të jenë të gjithë tenistët nga lista e paraqitur e tenistëve.

16 KËSHILLI MBIKQYRËS I KAMPIONATIT

- 16.1 Këshilli mbikqyrës i kampionatit është organi më i lartë i Kampionatit dhe përbëhet nga tre anëtarë dhe Udhëheqësi i Kampionatit. Anëtarët e Këshillit mbikqyrës i zgjedh Bordi i FTK-së.



FEDERATA E TENISIT TË KOSOVËS
TENISKA FEDERACIJA KOSOVA
TENNIS FEDERATION OF KOSOVA

www.tenniskosova.com; federation@tenniskosova.com; 044/14 22 90

16.2 Këshilli mbikqyrës i shqyrëton ankesat në shkallën e dytë. Vendimet i sjell me shumicë votash. Udhëheqësi i Kampionatit nuk ka të drejtë të votoj gjatë marrjes së vendimeve të shkallës së dytë.

17. ANKESAT

17.1 Ankesat në lidhje me takimet e kampionatit duhet të jenë në formë të shkruar dhe duhet të arrijnë në FTK më së voni deri në ora 16 të ditës së nesërme pas takimit.

17.2 Ankesat në shkallën e parë i zgjidh Udhëheqës i kampionatit në afat prej 48 orësh pas pranimit të ankesës në shkallën e parë. Ankesat në vendimin e Udhëheqësit të Kampionatit i zgjidh Këshilli Mbikqyrës në afat prej 48 orësh pas ankesës në shkallën e dytë. Vendimet e Këshillit Mbikqyrës janë vendimtare.

18 SHPENZIMET E KAMPIONATIT

18.1 Çdo ekip i bartë shpenzimet e tija të udhëtimit dhe të qëndrimit

18.2 Shpenzimet e referëve i bartë FTK

18.3 Shpenzimet e shpërblimeve sportive dhe të tjera i bartë FTK.

19 AKTET TJERA

19.1 Për të gjitha rastet që nuk janë të përfshira në këtë Rregullore fjalën kryesore në marrjen e vendimeve e ka Bordi i FTK.

19.2 Ndryshimin e Rregullorës e bënë Bordi i FTK. Ndryshimet në përmbajtjen e Rregullorës duhet të miratohen nga ana e Bordit të FTK-së para fillimit të sezonit në të cilën do të hyjnë në fuqi.

19.3 Rregullorja hyn në fuqi në datën që miratohet nga Kuvendi i FTK-së më 14 janar 2012

Në Prishtinë, 12 janar 2012

Kuvendi i FTK-së

**House of Sports,
Agim Ramadani str,
10000 Prishtina.
Kosovo**